

SHITJA GJATË MUAJIT PRILL NË SHARRCEM

**REZULTATE SHUMË TË MIRA**

Muaji prill, shënon kthesën e madhe në realizimin e shitjes dhe përcjelljes të të gjitha produkteve aktuale të kompanisë SHARRCEM drejtë blerësve të kësaj kompanie.

Sipas menaxherit të Departamentit të Shitjes e Marketingut z. Naxhid Raka, "është përmbushur në tërësi plani mujor dhe ate të të gjitha llojet e çimentos dhe sharmall-it".

Sendërtimi shumë i mirë i planit të shitjes i muajit prill dhe rezultatet që do të arrihen edhe gjatë muajve të ardhshëm, do të mundësojnë edhe plotësimin e atyre sasirave të produkteve të kompanisë SHARRCEM gjatë tremujorit të parë të këtij viti, që për shkak kushteve atmosferike, nuk

kishin patur arritje të planifikuar. Pra, të gjitha këto rrjedha në lëmin e shitjes, kërkojnë angazhime edhe më të mëdha të të gjithë akterëve në proces, në drejtim të plotësimit të kërkesave gjithnjë në rritje të blerësve në njërën anë dhe rrjedhimisht edhe të ngritjes së cilësisë së shërbimeve, që është një proces i vazhdueshëm i kompanisë SHARRCEM

**U NDA PJESA E DYTË E BONUS-it**

Gjatë muajit prill, punëtorët e kompanisë SHARRCEM, morën edhe pjesën e dytë të bonusit për vitin 2008.

Pjesa e dytë, në shumë prej 1.000 euro, u nda me rrogat e muajit mars të këtij viti.

Pjesën e mbetur, në shumë prej 931 euro, punëtorët e SHARRCEM -it, do ta marrin me rrogat e muajit prill të këtij viti.

**REKORD I RI:**

Më 16 prill të këtij viti 2009, në kompaninë SHARRCEM, është arritur që gjatë një dite, të përcjellen 3.237 tonelata produkte të ndryshme, që paraqet një rekord të ri në historinë e gjatë mbi 70-vjeçare të kësaj fabrike.

SHARRCEM ORGANIZON

**OPEN DAY**

Kompania SHARRCEM, për herë të parë do të organizojë një OPEN DAY në hapësirën e vet më 30 maj 2009 duke filluar nga ora 12 deri në orën 18.

Në këtë eveniment do të marrin pjesë komuniteti dhe mysafirët tjerë specialë, të cilët do të eksplorojnë progresin e arritur në SHARRCEM gjatë fiteve të fundit.

Ky OPEN DAY do të krijojë një atmosferë relaksuese, me muzikë, ushqime pije dhe ëmbëlsira të ndryshme si dhe lojëra të ndryshme për më të vegjëlit, të gjitha këto GRATIS nga kompania SHARRCEM.

**Në këtë numër**

- ▶ Trajnimi i stafit
- ▶ Broshura të reja
- ▶ Vazhdojnë përkrahjet
- ▶ Ne dhe ambienti
- ▶ Hapësira të reja të gjelbra
- ▶ Blerësit tanë: ENG CO

## BROSHURA TË REJA

### TRAJNIM I STAFIT

Me qëllim të përgatitjeve dhe avancimeve të të gjitha formave dhe metodave lidhur me shitjen e marketingun të punëtorëve të Departamentit të Shitjes e Marketingut të kompanisë SHARRCEM, kohë më parë, Zytari Kryesor Ekzekutiv i kompanisë SHARRCEM, z. Patrick Stapfer, organizoi një trajnim një ditor. Trajnimi në fjalë dhe trajnimet tjera që do të mbahen një herë në muaj, do të jenë të mirëseardhura për të gjithë punëtorët e Departamentit të Shitjes e Marketingut me qëllim të ofrimit të ndihmave në avancimin e njohjeve të tyre teknike në drejtim të ofrimit të përkrahjeve edhe më të mëdha blerësve.



Departamenti i Shitjes e Marketingut i kompanisë SHARRCEM, është në përfundim e sipër të përgatitje së një broshure të re.

Broshura në fjalë ka për qëllim ofrimin e shumë informacioneve dhe të dhënave tjera të nevojshme rreth përdorimit të betonit sidomos në temperatura të ulëta dhe të larta. Në te gjithashtu, jepen edhe procedurat e nevojshme të përdorimit të betonit, që për blerësit tanë dhe të gjithë prodhuesit e përdoruesit, mundëson një aktivitet shumë më të mirë.

Këto broshura do t'ju ndihmojnë blerësve tanë që me më efikasitet të aplikojnë të gjitha llojet e çimentos gjatë mënyrës së përdorimit të betonit.

Pas shtypjes së kësaj broshure, e njëjta di t'i shpërndahet të gjithë blerësve tanë dhe subjekteve tjera afariste që kanë të bëjnë me betonin.

SHARRCEM – KOMUNITETI

### VAZHDOJNË PËRKRAHJET


Kompania SHARRCEM, vazhdon përkrahjet dhe dhënien e ndihmave për aktivitete të ndryshme në komunitetin e Hanit të Elezit dhe Kaçanikut.

Në mbledhjen e fundit të Bordit Menaxhues, u vendos që kompania SHARRCEM të përkrah me mjete financiare Klubin Futbollistik "Sharri" në shumë prej 7.000 eurosh, në shumë prej 5.000 euro Klubin e Mundjes SHARRI nga Hani i Elezit, Sektorin për sport e rini të KK Kaçanikut me 600 euro si dhe Shkollën Filllore "Emin Duraku" në Kaçanik me 4 tonelata çimento për rregullimin e oborrit të shkollës.



## NË SILLOSIN E ÇIMENTOS NË REPARTIN E VJETËR

Këtyre ditëve, janë duke u ndërmarr disa aktivitete të nevojshme në Sillosin e çimentos në repartin e vjetër. Këto aktivitete, sipas menaxherit të Mbrojtjes së Ambientit, z. Halil Berisha, "kanë të bëjnë në rend të parë me aftësimin e sistemit të depluhimit nëpërmjet filtrit mekanik me thasë, me çka arrihet që shpërndarja e thërmijave të pluhurit të eliminohet."



## DITA BOTËRORE E TOKËS

Shënimi i Ditës Botërore të Tokës, 22 prilli, u shënuar edhe në Hanin e Elezit, me disa aktivitete të cilat kishin për qëllim organizimin e një aksioni të përgjithshëm në grumbullimin e mbeturinave dhe pastrimin e disa ambienteve nëpër pika të ndryshme.

Në këtë aksion, muarrën pjesë nxënës të shkollave të ndryshme, OJQ, KFOR-i, OSBE etj. Pjesë e këtij aksioni si edhe deri më tani, ishte edhe kompania SHARRCEM, e cila kontribuoi me një numër të caktuar punëtorësh dhe me mekanizëm përcjellës.

## HAPËSIRA TË REJA TË GJELBRA

Kompania SHARRCEM, po vazhdon me sukses rritjen e sipërfaqeve të gjelbërta përreth objekteve të saja.

Vetëm gjatë muajve të kaluar, janë krijuar shumë hapësira të reja të gjelbra e në veçanti ato në drejtim të ndërtesës administrative dhe repartit të vjetër.

Të gjitha këto aktivitete në drejtim të kimit të një ambienti vërtetë ekologjik brenda dhe jashtë kompanisë SHARRCEM, janë edhe një nga prioritetet e kompanisë Holcim, e që SHARRCEM, është anëtare e kësaj familje të madhe.



BLERËSIT TANË



Ndërmarrja ENG-CO nga Llapushniku i Drenasit, me pronar Esat Gashi, që nga viti 2000, në afarizmin e saj, ka çimento dhe sharmall vetëm të kompanisë SHARRCEM dhe sipas z. Esat, nuk ka ndërmend të ndrojtë asgjë nga afarizmi dhe raporti i tij me SHARRCEM.

Z. Esat, na thoni ju lutem, çfarë ju ka shtyrë juve në ENG-CO të keni për partner kompaninë SHARRCEM gjatë tërë këtyre viteve të kaluara?

“Në rend të parë ju falënderoj për këtë vizitë, që për ne në ENG-CO, është një dëshmi se vërtetë keni një kujdes për blerësit e juaj qofshin ata që furnizohen në mënyrë të drejtpërdrejtë apo indirekte siç është rasti me ne. Është e vërtetë se ne furnizohemi vetëm me produkte të SHARRCEM-it, pra të të gjitha llojeve të çimentos dhe sharmall. Kur kemi të bëjmë me kompaninë SHARRCEM, ne jemi vërtetë të kënaqur me cilësinë e produkteve dhe shërbimeve të ofruara që dita më ditë po avancohen në dobi të dy palëve.”

Z. Esat, pos këtyre që thatë a ka ndonjë të veçantë apo që vlen të theksohet si pozitive për këtë bashkëpunim të ndërsjellë dhe të suksesshëm?

“Pos cilësisë dhe shërbimeve, duhet të theksohen edhe



raportet shumë të mira që kemi me Departamentin e Shitjes, ku përfaqësues të tij na vizitojnë rregullisht, por nuk ka asnjë pengesë për komunikim dhe marrje të informacioneve të cilat janë të dobishme për ne. Dua të përmend edhe ato takime të rregullta që kompania SHARRCEM po i organizon me blerësit e vet, në të cilat po njoftohemi në mënyrë të drejtpërdrejtë me gjithë ata që ndodh apo planifikohet të ndodhë në SHARRCEM.”

Tani jemi veç në muajt e parë të këtij viti. Çfarë keni planifikuar z. Esat në raport me furnizim të çimentos dhe sharmallit?

“Vitin 2008 e kemi përmbyll me sukses. Sa i përket këtij viti, pra 2009, ne jemi të orientuar vetëm në llojet e çimentos dhe sharmallit të kompanisë SHARRCEM edhe pse në regjionin tonë mund të gjinden këso produkte të prodhuesve tjerë në regjion jashtë Kosovës.”

Z. Esat, ju faleminderit për këtë bisedë .

“Ishte kënaqësi edhe për ne në ENG-CO, që sot kishim për vizitë përfaqësues të kompanisë SHARRCEM”.



*I mbajmë premtimet!*  
**SHARRCEM**